VENDIM
Nr. 213, datë 9.4.2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 41/2023, MARRËVESHJES SË GRANTIT PËR MASAT SHOQËRUESE, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 182, DATË 29.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, MARRËVESHJES SË GRANTIT TË INVESTIMIT, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 184, DATË 29.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, MARRËVESHJES SË GRANTIT SECO, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 183, DATË 29.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NDËRMJET *KFW FRANKFURT AM MAIN* DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT, PËR PROGRAMIN "MENAXHIMI I QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE TË NGURTA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes të huas, ratifikuar me ligjin nr. 41/2023, marrëveshjes së grantit për masat shoqëruese, miratuar me vendimin nr. 182, datë 29.3.2023, të Këshillit të Ministrave, marrëveshjes së grantit të investimit, miratuar me vendimin nr. 184, datë 29.3.2023, të Këshillit të Ministrave, marrëveshjes së grantit SECO, miratuar me vendimin nr. 183, datë 29.3.2023, të Këshillit të Ministrave, ndërmjet *KfW Frankfurt Am Main* dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për programin "Menaxhimi i qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Fusha e biznesit
Banka për Zhvillim, KfW
Karolin Katlun
Ref. jonë: RkJ
Telefon: +49 69 7431-2729
Carolin.Katlun@kfw.de

7.2.2025

Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta

- **50,000,000.00 euro Marrëveshje Huaje (BMZ nr. 2018 68 199), datë 29 dhjetor 2022.**
- **6,900,000.00 euro Marrëveshje Granti Investimi (BMZ nr. 2018 67 167), datë 29 dhjetor 2022.**

- **5,000,000.00 euro Marrëveshje Shoqëruese e Grantit (BMZ nr. 2018 70 344), datë 29 dhjetor 2022.**

- **4,750,000.00 Euro Marrëveshja e Grantit SECO e datës 29 dhjetor 2022.**

Ndryshimi i marrëveshjeve të lartpërmendura.

Për të gjithë të interesuarit,

Me anë të kësaj i referohemi marrëveshjeve financiare të mëposhtme:

Marrëveshje Huaje 50,000,000.00 euro, e datës 29 dhjetor 2022, ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave si Huamarrës **("Huamarrësi"** ose **"ju")** në lidhje me projektin "Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta", sipas BMZ-së nr. 2018 68 199, siç garantohet nga Republika Federale e Gjermanisë **("Marrëveshja e Huas")**.

- Marrëveshje Granti 6,900,000.00 euro, e datës 29 dhjetor 2022, ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit si marrës në lidhje me projektin "Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta", sipas BMZ-së nr. 2018 67 167 **("Marrëveshja e Grantit të Investimeve")**.

- Marrëveshje Granti 5,000,000,00 euro për masat shoqëruese, e datës 29 dhjetor 2022, ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit si marrës, në lidhje me projektin "Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta", sipas BMZ-së nr. 2018 70 344 **("Marrëveshja Shoqëruese e Grantit")**; dhe

- Marrëveshje Granti 4,750,000.00 euro e financuar nga SECO, e datës 29 dhjetor 2022, ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit si marrës, në lidhje me projektin "Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta" (**"Marrëveshja e Grantit SECO"** dhe së bashku me Marrëveshjen e Huas, Marrëveshja Investimi e Grantit dhe Marrëveshja Shoqëruese e Grantit, **"Marrëveshjet"** dhe secila një **"Marrëveshje"**).

Bazuar në *e-mail*-in e dërguar nga Ministria e Financave të datës 14 maj 2024 për KfW-në dhe konsultimet për zëvendësimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e projektit në ditët në vijim, ne propozojmë ndryshimin e Marrëveshjeve, si më poshtë:

Seksioni 1

Interpretimi

Në bazë të çdo dispozite të shprehur në kundërshtim më këtë shkresë ose nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe të përcaktuara në Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim në këtë shkresë.

Seksioni 2

Amendimet

Marrëveshjet do të ndryshohen si më poshtë:

a) Në lidhje me nenin 1.2 të Marrëveshjes së Huas, referenca për "nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve ("Njësia e Koordinimit të Programit" ose "PCU")" fshihet dhe zëvendësohet me "nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve ("Njësia e Koordinimit të Programit" ose "PCU".

b) Në lidhje me nenin 1.2 të Marrëveshjes së Grantit të Investimit, Marrëveshjen Shoqëruese të Grantit dhe Marrëveshjen e Grantit SECO referenca për ", e cila vepron nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve ("Njësia e Koordinimit të Programit" ose "PCU")," do të fshihet dhe zëvendësohet me fjalën "nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve ("Njësia e Koordinimit të Programit" ose "PCU")".

c) Në çdo Marrëveshje, çdo referencë për "Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ("MIE")" dhe "MIE" do të fshihet në çdo Marrëveshje dhe do të zëvendësohet me "Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit".

Seksioni 3
Dispozita të ndryshme

3.2. Kjo shkresë nuk ndryshon ose nuk heq dorë nga asnjë dispozitë tjetër e ndonjë prej Marrëveshjeve dhe, në veçanti, nuk përbën heqje dorë në lidhje me ndonjë nga të drejtat e KfW-së, sipas ndonjë Marrëveshjeje, përveçse të përcaktuara qartë në këtë shkresë. Dispozitat e ndonjë prej Marrëveshjeve, me përjashtim të ndryshimeve me këtë shkresë, do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë.

3.3. Huamarrësi, me kërkesën e KfW-së dhe me shpenzimet e tij, do të kryejë të gjitha veprimet e tilla dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, të arsyeshëm ose të dëshirueshëm për t'i dhënë efekt ndryshimeve të kryera ose që do të kryhen në përputhje me këtë shkresë.

Seksioni 4
Përfshirja e kushteve

Dispozitat e nenit 9 *(Shpenzimet dhe tarifat publike),* neni 12.1 *(Përfaqësimi i Huamarrësit),* neni 14.3 *(Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet)*, neni 14.5 (Caktimi), neni 14.6 *(Ligji në fuqi)* dhe neni 14.9 *(Mosmarrëveshjet ligjore)* të Marrëveshjes së Huas (të ndryshuar nga kjo shkresë) dhe nenet përkatëse të Marrëveshjes së Financimit (të ndryshuar nga kjo shkresë), Marrëveshjes së Financimit, Masat Shoqëruese (të ndryshuar nga kjo shkresë) dhe Marrëveshja e Grantit SECO (të ndryshuar nga kjo shkresë) do të përfshihen në këtë shkresë, sikur të përcaktohen plotësisht në këtë shkresë dhe sikur referenca në ato klauzola për "Marrëveshjen", "këtë Marrëveshje", "Marrëveshjen e Huas", "këtë Marrëveshje Huaje", "Marrëveshjen e Financimit", "këtë Marrëveshje Financimi", "Marrëveshja e Grantit" ose "këtë Marrëveshje Granti" janë referenca për këtë shkresë.

Do t'ju ishim mirënjohës nëse mund të konfirmonit se jeni dakord dhe pranoni termat dhe kushtet e kësaj shkrese, duke e sigluar këtë shkresë në një formë ligjërisht të detyrueshme, siç tregohet në faqen e nënshkrimit më poshtë dhe duke i kthyer KfW-së një kopje origjinale të kësaj shkrese të sigluar.

(Në vijim faqja e nënshkrimit.)

Me respekt,

KfW

Florian Sekinger
Drejtues Departamenti

Brit Horschke
Drejtor i KfW për Shqipërinë

Në kopje

Ne pranojmë dhe pajtohemi me termat dhe kushtet e përcaktuara në Shkresën tuaj të datës 07.02.2025

Data: 14.02.2025

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave

Petrit Malaj
Ministër i Financave

Data: 14.02.2025

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Belinda Balluku
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Data: 14.02.2025

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Mirela Kumbaro Furxhi
Ministër i Turizmit dhe Mjedisit